**VENDIM**
**Nr. 64, datë 22.7.2014**

**MBI MIRATIMIN E INVESTIMEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 14, të vendimit të Bordit të Komisionereve të ERE-s nr. 1, datë 10.1.2013 "Për emërimin e administratorit dhe kompetencat e tij", Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.7.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupit të punës në lidhje me kërkesën e "CEZ Shpërndarje" për investim emergjent në fuqizimin e N/St. Qendër Tiranë,

konstatoi se:

Me realizimin e investimit të kërkuar arrihet:

- Rritje e shkallës së sigurisë së furnizimit me energji elektrike të përdoruesve.
- Përmirësohet cilësia e furnizimit me energji elektrike, veçanërisht niveli i tensionit.
- Ulje e humbjeve teknike të energjisë elektrike në zonat përkatëse të rrjetit të shpërndarjes.

Për sa më sipër konstatuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë fuqizimin e N/Stacionit Qendër Tiranë (Transformator 110/20 kV me fuqi 50/80 MVA).
2. Të miratojë ndërtimin e linjave kabllore 20 kV që dalin nga N/Stacioni Qendër Tiranë dhe ndarjen e fiderave të mbingarkuar (324, 326, 330, 312, C3, C6).
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**